



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr _____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 671, datë 14.11.2024

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE
TË VEÇANTA NË NJË GJYKATË TJETËR, TË NDRYSHME NGA AJO KU
USHTRONË FUNKSIONIN NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Taulant Banushi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Besjana Garxenaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me: Të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 287, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Migena Laska dhe Sokol Pasho, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me: Të pandehur: {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/2, 283/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Entela Shedula, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me: Të pandehur: {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Kujtim Vraniçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me: Persona nën hetim: {...} dhe {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 80, 278/1, 28/4, 186, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal; (në seancë paraprake); Objekti: “Pushimi i hetimeve në ngarkim të personave nën hetim {...} dhe {...}”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Kujtim Vraniçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me: Të pandehur: {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh, 278/1, 28/4, 139, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal; (në seancë paraprake); Objekti: “Dërgimi në gjyq në ngarkim të të pandehurit {...}”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR